



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bordi i Administrimit

Nr. 1031 Prot

Shkodër, me 19.03 2024

V E N D I M

Nr. 86 datë 19.03.2024

"Për miratimin e kërkesës për shërbime me fonde buxhetore për trajnimin e mësueseve në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtarë të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025 "

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të larta në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të pikës 1 dhe 2 të vendimit 188 datë 13.03.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre" dhe në kuadër të zbatimit të programit Kombëtarë të Zhvillimit Profesional të Mësueseve 2024-2025 " të miratuar me shkresën nr.1215/1 prot datë 19.02.2024 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në fushën e trajnimeve", Bordi i Administrimit me vendim qarkullues të datës 19.03.2024

Vendosi

1. Miratimin e kërkesës për shërbime me fonde buxhetore për trajnimin e mësueseve në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtarë të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025 (bashkengjitur materiali).
2. Ngarkohet kryetarja e SA-së dhe Administratori i USH -së për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof.as.dr Adrian LEKA



Nr: 936 Prot

Dt: 08.03.2024



Naim Frashëri
N. P. P. P.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 190 Prot.

Tiranë, më 08.03.2024

Lënda: Kërkesë për shërbime me fonde buxhetore për trajnimin e mësuesve në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025

UNIVERSITETIT TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË DURRËSIT "ALEKSANDER MOISIU"
UNIVERSITETIT TË GJIROKASTRËS "EQEREM ÇABEJ"
UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
UNIVERSITETIT TË KORÇËS "FAN S. NOLI"
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
UNIVERSITETIT TË VLORËS "ISMAIL QEMALI"

Në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025 të miratuar me shkresën Nr.1215/1 Prot. datë 19.02.2024 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në fushën e trajnimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka planifikuar të realizojë komponentët për:

- Trajnimin e mësuesve të lëndëve: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi) për aftësitë që zhvillohen në vlerësimin ndërkombëtar PISA dhe sipas qasjes STEM;
- Trajnimin e mësuesve të arsimit fillor në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre për aftësitë që zhvillohen në vlerësimet ndërkombëtare PIRLS, TIMSS sipas qasjes STEM;
- Trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar për aftësitë efektive të mësuesit si: zgjidhja e konflikteve, aftësitë e komunikimit dhe të etikës.

Për realizimin e trajnimeve me cilësi dhe efektivitet, ASCAP ka planifikuar në buxhetin e vitit 2024, shpërndarjen e fondit për secilin rajon si më poshtë:

Rajoni I ku përfshihet: Has, Kukës, Kurbin Lezhë Malësi e Madhe Mirditë Pukë Shkodër, Tropojë, Vau Dejës) – Fondi i parashikuar 4,110,050 (katër milionë e njëqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

Rajoni II ku përfshihet: Peqin, Elbasan Dimal Belsh, Skrapar, Poliçan, Berat Kuçovë, Gramsh, Librazhd, Cërrik- Fondi i parashikuar 3,206,770 (tre milionë e dyqind e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë.

Rajoni III ku përfshihet: Kolonjë, Maliq, Përrenjas, Korçë- Pustec, Pogradec, Devoll- **Fondi i parashikuar 1,582,150 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë**

Rajoni IV ku përfshihet: Bulqizë, Dibër, Kamëz, Klos, Mat, Vorë, Tiranë- **Fondi i parashikuar 4,852,200 (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë.**

Rajoni V ku përfshihet: Durrës, Kavajë, Krujë, Rrogozhinë, Shijak - **Fondi i parashikuar 1,585,950 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.**

Rajoni VI ku përfshihet: Divjakë, Fier, Mallakastër, Patos, Roskovec, Selenicë, Vlorë-Himarë, Lushnje - **Fondi i parashikuar 2,919,290 (dy milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë.**

Rajoni VII ku përfshihet: Finiq-Dropull, Gjirokastrë – Libohovë, Përmet – Këlcyre, Sarandë-Konispol-Delvinë, Tepelenë-Memaliaj- **Fondi i parashikuar 837,690 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.**

Bazuar në pikën 1 dhe 6 të vendimit 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, kërkojmë nga ana juaj shprehjen e interesit, referuar fushave të veprimit, për shërbimin e trajnimeve të mësuesve për rajonin që do të mbuloni.

Lutemi të na ktheni përgjigje zyrtare për shprehjen e interesit brenda datës 11.03.2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Gerti JANAQI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORI

Nr. 936/ Prot

Shkodër, më 08. 03. 2024

Lënda: Përgjige e shkresës së ASCAP nr. 190 protok., datë 06.03.2024 "Kërkesë për shërbime me fonde buxhetore për trajnimin e mësuesve në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025"

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

TIRANË

Në përgjige të shkresës nr. 190 protok., datë 06.03.2024 "Kërkesë për shërbime me fonde buxhetore për trajnimin e mësuesve në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025", shprehim interesin tonë për kryerjen e shërbimit të trajnimit të mësuesve për rajonin I ku përfshihet: Hasi, Kukësi, Kurbini, Lezha, Malësia e Madhe, Mirëdita, Puka, Shkodra, Tropoja dhe Vau i Dejës), referuar fushave të veprimit:

- Trajnimin e mësuesve të lëndëve: Gjuhë Shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi) për aftësitë që zhvillohen në vlerësimin ndërkombëtar PISA dhe sipas qasjes STEM.
- Trajnimin e mësuesve të arsimit fillor në lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë dhe Dituri Natyre për aftësitë që zhvillohen në vlerësimet ndërkombëtare PIRLS, TIMSS, sipas qasjes STEM.
- Trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar për aftësitë efektive të mësuesit si: zgjidhja e konflikteve, aftësitë e komunikimit dhe etikës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTORI

Prof. dr. **Edmond KEÇIRA**



Nr: 936/2 Prot
dt: 12.03.2024



20 Rukoni
Fatmir
Vasili
Korçanin
FSH SH
& SH N
zgjuro të
varam bashkë
(për ofrimin)
Ded

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 220 prot.

Tiranë, më 11 .03.2024

Lënda: Për vazhdim procedure

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"


Në vijim të shkresës suaj nr. 936/1 Prot., datë 08.03.2024 nëpërmjet të cilës shprehni interesin për shërbimin e trajnimeve në *Rajonin I ku përfshihet: Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë, Shkodër, Tropojë dhe Vau Dejës*, pjesë e Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025, të planifikuar në buxhetin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për vitin 2024, për vazhdimin e procedurës në zbatim të pikave 2 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 13.03.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre", *bashkëlidhur po ju dërgojmë termat e referencës dhe udhëzimet në kuadër të zbatimit të shërbimit.*

Lutemi për të vazhduar procedurën sipas parashikimeve të pikës 4 të VKM nr. 188, datë 13.03.20219, dërgoni brenda 10(dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit vlerësimet tuaja për shërbimin (ofertën tuaj sipas Kapitullit III, pika 3.3/h të termave të referencës).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Gerti JANAQI



Adresa: Rruga: " Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë , Email : sekretaria@ascap.edu.al, Web site: www.ascap.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 2181/2024 prot.

Tiranë, më 11.03.2024

TERMAT E REFERENCËS – RAJONI 1

ZVAP-të: Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë, Shkodër, Tropojë, Vau i Dejës

Titulli

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025, i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr.1215/1 prot., datë 19.02.2024.

Komponenti 1

Trajnimi i mësuesve të lëndëve/ profileve: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë dhe Shkencat e natyrës (Fizikë, Biologji, Kimi), për aftësitë që vlerësohen në studimin ndërkombëtar PISA dhe sipas qasjes STEM.

Komponenti 2

Trajnimi i mësuesve të arsimit fillor në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre për aftësitë që vlerësohen në studimet ndërkombëtare PIRLS, TIMSS sipas qasjes STEM.

Komponenti 7

Trajnimi i mësuesve të arsimit parauniversitar për aftësitë efektive të mësuesit, si zgjidhja e konflikteve, aftësitë e komunikimit dhe të etikës.

1. PASQYRA E PËRGJITHSHME

Në shoqërinë e sotme, mësuesit kanë për detyrë jo vetëm të japin njohuri, por edhe të kultivojnë mendimin kritik në gjuhë, matematikë, shkencë dhe TIK. Përqafimi i kësaj sfide dinamike kërkon një përkushtim ndaj të nxëniet gjatë gjithë jetës, duke e bërë zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP) domosdoshmëri për çdo mësues.

Në një epokë digjitale, të *lexuarit* shtrihet përtej dekodimit të informacionit, duke përfshirë përdorimin e platformave online dhe të burimeve multimediale. ZHVP për aftësitë e të lexuarit siguron që mësuesit t'i njohin dhe t'i zhvillojnë këto aftësi gjithnjë e në zgjerim, duke i udhëhequr nxënësit në kuptimin, reflektimin, përdorimin dhe vlerësimin kritik të informacionit.

STEM si qasje arsimore ndërdisiplinore integron katër fusha: Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë. Qëllimi i edukimit STEM është t'u ofrojë nxënësve njohuri dhe aftësi të qëndrueshme dhe të integruara në këto fusha, duke nxitur të menduarit kritik, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe kreativitetin.

Matematika, e perceptuar shpesh si një lëndë "e vështirë", bëhet më e arritshme me ZHVP-në efektive. Mësuesit e pajisur me strategjitë më bashkëkohore pedagogjike dhe mjetet teknologjike, mund t'i transformojnë parimet abstrakte matematikore në zbatime të prekshme të botës reale.

Shkenca qëndron në ballë të nxitjes së kuriozitetit dhe të të menduarit analitik. Nëpërmjet iniciativave të synuara të ZHVP-së, mësuesit mund të hulumtojnë në zbulimet e fundit, metodologjitë eksperimentale dhe qasjet e të mësuarit të bazuara në kërkim.

Revolucioni digjital ka riformuar paradigmen arsimore, duke i bërë aftësitë digjitale një aspekt integral i mësimdhënies bashkëkohore. ZHVP për aftësitë digjitale i pajis mësuesit me mjetet për të integruar teknologjinë në orët mësimore, duke krijuar mjedise mësimore ndërvepruese dhe tërheqëse.

Në këtë kuadër, MAS ka miratuar Programin Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025", (më poshtë Programi). Ky program synon të krijojë një mjedis arsimor dinamik dhe gjithëpërfshirës, ku mësuesit të jenë udhëheqës në formimin e një brezi të ri nxënësish të përgatitur për shekullin XXI.

Për hartimin e programit janë angazhuar të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë institucionet arsimore parauniversitare, institucionet e arsimit të lartë, organizatat që kanë në fokus arsimin etj.

Programi reflekton realitetet dhe nevojat e mësuesve tanë, duke qenë në koherencë me qëllimet e arsimit parauniversitar dhe me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, përmbush standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar, si dhe standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.

Programi do të zbatohet mbi parimet e mëposhtme:

- Programi është i detyrueshëm për të gjithë mësuesit që përfshihen në veprimtari të planifikuara në këtë program.
- Programi ofron veprimtari të qarta të procesit të zhvillimit profesional të mësuesve që kontribuojnë për rritjen e tyre profesionale.
- Një gamë e gjerë materialesh do të jetë në dispozicion të të gjithë mësuesve përmes të të cilave do të organizohet zhvillimi profesional.
- Zbatimi i programit do të bazohet në bashkëpunim, gjithëpërfshirje, përgjegjshmëri dhe angazhim.
- Institucionet përgjegjëse do të angazhohen për koordinimin dhe sigurimin e cilësisë në zbatimin e programit.

Qëllimi i programit

Qëllimi i Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025 është ***përmirësimi i rezultateve të të nxënësve*** përmes zhvillimit profesional të mësuesve, të koordinuar dhe të institucionalizuar me të gjithë “aktorët” në fushën e arsimit me fokus të lexuarit, matematikën, shkencat e natyrës, aftësitë digjitale, gjithëpërfshirjen dhe aftësitë efektive.

Objektivat e programit

Objektivat e përgjithshme të programit janë:

- ***Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së arsimit parauniversitar duke rritur standardin arsimor*** nëpërmjet përafrimit të metodologjisë së mësimdhënies me qasjen STEM dhe me kornizat e vlerësimeve ndërkombëtare për nxitjen e rezultateve më të mira të nxënësve.
- ***Përmirësimi i performancës së nxënësve*** nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të mësuesve për të zbatuar metoda që rrisin aftësitë e nxënësve në zhvillimin e mendimit kritik, të vlerësuara

edhe nga vlerësimet ndërkombëtare për të lexuarit, matematikë, shkencat e natyrës (fizikë, biologji, kimi).

- *Nxitja e inovacionit* nëpërmjet pajisjes së mësuesve me aftësi digjitale që u mundësojnë atyre të integrojnë teknologjinë në mënyrë efektive në praktikat e mësimitdhënies.
- *Zhvillimi profesional i mësuesve* nëpërmjet sigurimit të mbështetjes së nevojshme për ngritjen e kapaciteteve që ata të qëndrojnë të përditësuar me praktikat dhe me metodologjitë më të mira, në funksion të përmirësimit të mësimitdhënies dhe të rezultateve të nxënësve.
- *Lidhja e mësimitdhënies me vlerësimin* për të aftësuar mësuesit në interpretimin e të dhënave të vlerësimit të nxënësve në mënyrë efektive, në përdorimin e tyre si një mjet për të përshtatur metodat e mësimitdhënies, si dhe në adresimin e nevojave për të përmirësuar arritjet e të nxënësve.
- *Motivimi i barazisë dhe i përfshirjes* nëpërmjet adresimit të nevojave të nxënësve, sigurimit që të gjithë të kenë akses të barabartë në arsimin cilësor, si dhe mbështetje për rezultate progresive.
- *Vendosja e treguesve të qartë cilësorë* për monitorimin dhe për vlerësimin e performancës së nxënësve.

2. NEVOJA PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE TË MËSUESVE PËR PËRMIRËSIMIN E MËSIMDHËNIE - NXËNIES SIPAS QASJES STEM

Sigurimi i cilësisë në arsim dhe rritja e profesionalizimit të mësuesve udhëheqin gjithë angazhimin institucional të MAS-it në kuadër të prioritetëve të saj dhe të përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Të gjitha hulumtimet tregojnë se cilësia e mësimitdhënies është faktor përcaktues për arritjet e nxënësve.

Nevoja për hartimin e Programit lidhet me:

- *Sigurimin e cilësisë në arsim.* Investim në përditësimin e kurrikulës, zhvillimin profesional të mësuesve dhe mekanizma për monitorimin e cilësisë.
- *Përmirësimin e mësimitdhënie - nxënies.* Mësues të pajisur me aftësi të përparuara pedagogjike dhe me aftësi të përmirësuara në vlerësimin e nxënësve.
- *Rritjen e profesionalizimit të mësuesve.* Mësues të zhvilluar profesionalisht nëpërmjet metodologjive praktike dhe bashkëkohore në fushat e gjuhës shqipe dhe letërsisë, matematikës, shkencave të natyrës dhe teknologjisë.
- *Rezultatet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.* Instrumente që duhen përdorur për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

- *Inovacionin.* Nxitja e inovacionit nëpërmjet pajisjes së mësuesve me aftësi digjitale dhe integritit të teknologjisë në mënyrë efektive në praktikat e mësimdhënies.
- *Arsimin gjithëpërfshirës.* Motivim i barazisë dhe i përfshirjes nëpërmjet adresimit të nevojave të nxënësve, aksesit të barabartë dhe mbështetjes për rezultate progresive.

Roli i institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në zhvillimin profesional të mësuesve

Roli i institucioneve të arsimit të lartë në zhvillimin profesional të mësuesve dhe në zbatimin e këtij programi është shumë i rëndësishëm. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të formimit fillestar të mësuesve, si diploma Bachelor dhe Master në arsim, të cilat u ofrojnë mësuesve aspirantë njohuritë, aftësitë dhe strategjitë e nevojshme pedagogjike për të qenë mësues efektivë.

Institucionet e arsimit të lartë gjithashtu kanë qendrat e edukimit në vazhdim, të cilat ofrojnë trajnime të specializuara dhe të akredituara që u mundësojnë mësuesve të thellojnë njohuritë e tyre në fusha specifike lëndore, praktikat e metodologjisë, edukimin special, edukimin STEM, drejtimin e shkollës, menaxhimin e konflikteve, menaxhimin e klasës, teknologjinë në procesin mësimor etj., duke rritur efektivitetin e tyre në klasë dhe duke u mundësuar mësuesve të qëndrojnë aktualë me tendencat dhe praktikat më të mira në arsim.

Nga ana tjetër institucionet e arsimit të lartë angazhohen në kërkime dhe studime kërkimore që analizojnë praktikën e mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulës dhe politikën arsimore për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien dhe të nxënësve.

3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E DETYRËS

3.1 Qëllimi i detyrës

Qëllimi i detyrës është zhvillimi profesional i mësuesve në rajonin I me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe me njësitë arsimore vendore: Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë, Shkodër, Tropojë, Vau i Dejës, përmes realizimit të trajnimit të tyre, i koordinuar dhe i institucionalizuar me institucionet përkatëse, me fokus të lexuarit, matematikën, fizikën, biologjinë, kiminë dhe menaxhimin e konflikteve për të përmirësuar rezultatet e të nxënësve.

3.2 Objektivat e detyrës

Objektivi 1. Të trajnohen mësuesit e arsimit të mesëm të ulët (AMU) dhe të arsimit të mesëm të lartë (AML) në lëndët/profilet: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi për metodat efektive të mësimdhënies -nxënies gjatë orës mësimore, si dhe për zbatimin e njohurive lëndore në situata të jetës reale.

Objektivi 2. Të trajnohen mësuesit e arsimit fillor në lëndën e matematikës për metodat efektive të mësimdhënie -nxënies gjatë orës mësimore.

Objektivi 3. Të trajnohen drejtuesit e shkollave, oficerët e sigurisë dhe punonjësit e shërbimit psiko-social për menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

3.3 Rezultatet e pritshme nga realizimi i detyrës

Rezultatet e pritshme nga realizimi i detyrës janë si më poshtë:

- a) Trajnimi i rreth 3600 mësuesve të arsimit fillor, të AMU-së dhe të AML-së, drejtuesve të shkollave, oficerëve të sigurisë dhe punonjësve të shërbimit psiko-social. *Në aneksin 1 paraqitet tabela me numrin e mësuesve sipas ZVAP-eve dhe profileve përkatëse.*
- b) Trajnimi do të zhvillohet në periudhën: mars – dhjetor 2024.
- c) Trajnimi për një modul do të përmbajë trajnimin e drejtpërdrejtë me pjesëmarrje (9 orë), si dhe punët e pavarura dhe detyrat e pjesëmarrësve (9 orë).
- d) Modulet e trajnimit që do të zhvillohen janë:
 - **Moduli 1 për mësuesit e AMU-së dhe të AML-së:** Përmirësimi i cilësisë së procesit të mësimdhënie – nxënies me fokus zbatimin e njohurive dhe të aftësive lëndore në situata të jetës reale, në lëndën/ profilin: Gjuhë shqipe dhe letërsi ose Matematikë ose Fizikë ose Biologji ose Kimi.
 - **Moduli 2 për mësuesit e AMU-së dhe të AML-së:** Përdorimi i metodave efektive të mësimdhënie - nxënies gjatë orës mësimore, në lëndën/profilin: Gjuhë shqipe dhe letërsi ose Matematikë ose Fizikë ose Biologji ose Kimi
 - **Moduli 1 për mësuesit e arsimit fillor:** Përdorimi i metodave efektive të mësimdhënie - nxënies gjatë orës mësimore, në lëndën e matematikës.
 - **Moduli 1 për drejtuesit e shkollave, oficerëve të sigurisë, punonjësve të shërbimit psiko-social:** Zhvillimi i aftësive efektive të mësuesit me fokus zgjidhjen e konflikteve.
- e) Kohëzgjatja e trajnimit të drejtpërdrejtë do të jetë:
 - Mësuesit e AMU-së dhe të AML-së së *gjuhës shqipe dhe të letërsisë* do të zhvillojnë 2 (dy) module trajnimi me nga 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë për secilin modul. Gjithsej janë 4 ditë trajnimi. Secila ditë do të ketë 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 18 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.
 - Mësuesit e AMU-së dhe të AML-së së *matematikës* do të zhvillojnë 2 (dy) module trajnimi me nga 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë për secilin modul. Gjithsej janë 4 ditë trajnimi.



Secila ditë do të ketë 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 18 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.

Mësuesit e AMU-së dhe të AML-së së *fizikës* do të zhvillojnë 2 (dy) module trajnimi me nga 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë për secilin modul. Gjithsej janë 4 ditë trajnimi. Secila ditë do të ketë 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 18 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.

- Mësuesit e AMU-së dhe të AML-së së *biologjisë* do të zhvillojnë 2 (dy) module trajnimi me nga 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë për secilin modul. Gjithsej janë 4 ditë trajnimi. Secila ditë do të ketë 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 18 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.
- Mësuesit e AMU-së dhe të AML-së së *kimisë* do të zhvillojnë 2 (dy) module trajnimi me nga 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë për secilin modul. Gjithsej janë 4 ditë trajnimi. Secila ditë do të ketë 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 18 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.
- Mësuesit e arsimit fillor do të zhvillojnë 1 (një) modul trajnimi në 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë me nga 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 9 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.
- Drejtuesit e shkollave, oficerët e sigurisë dhe punonjësit e shërbimit psiko-social do të zhvillojnë 1 (një) modul trajnimi në 2 ditë trajnimi të drejtpërdrejtë me nga 4.5 orë trajnimi në ditë. Pra gjithsej janë 9 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.

f) Grupet e trajnimit do të formohen me rreth 20-25 mësues për çdo grup. Në rajonin 1 formohen rreth 159 grupe trajnimi.

g) Nisur nga shpërndarja gjeografike trajnimi do të zhvillohet nga trajneri në **qendrat e trajnimit për rajonin 1, si më poshtë:**

- Shkodër, ku përfshihen ZVAP-të: Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau i Dejës.
- Kukës, ku përfshihen ZVAP- të: Kukës dhe Has.
- Lezhë, ku përfshihen ZVAP- të: Lezhë, Kurbin dhe Mirditë.
- Tropojë, ku përfshihet ZVAP Tropojë.

h) Parashikimi i kostos për këtë rajon është 4,110,050 (katër milionë e njëqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- Trajnime
- Dieta
- Transporti
- Fotokopje, certifikata

4. KRITERET E IAL-SË PËR ZBATIMIN E DETYRËS

A. Kritere për IAL-në në realizimin e trajnimeve:

- a) IAL duhet të ketë përvojë të paktën 3-vjeçare në organizimin e trajnimeve të mësuesve.
- b) IAL duhet të ketë demonstruar më parë aftësi të mira në hartimin e planeve të trajnimeve dhe në zbatimin përpiktë të tyre.
- c) IAL duhet të ketë demonstruar më parë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi me institucione të tjera për të realizuar trajnime.
- d) IAL duhet të ketë demonstruar aftësi të mira të raportimit me shkrim të realizimit të trajnimeve me mësues.

B. Kritere për trajnerët e IAL-së në zhvillimin e trajnimeve:

Trajnerët që do të trajnojnë mësuesit duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:

- a) Formim akademik në fushën përkatëse: *Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi, Arsim fillor, Shkenca sociale.*
- b) Përvojë e mirë në ofrimin e trajnimeve me cilësi të lartë.
- c) Përvojë pune akademike në fushën përkatëse.
- d) Botime të studimeve, artikujve, librave etj., në fushën përkatëse të edukimit.

C. Kërkesa të tjera:

- a) Gatishmëri për të udhëtuar në qytete të ndryshme të Shqipërisë.
- b) Gatishmëri për punë gjatë fundjavave.
- c) Zotërim i aftësive për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë dhe të platformave interaktive.
- d) Aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese.

5. PËRSHKRIMI I PËRGJEGJËSIVE

Për realizimin e trajnimeve të mësuesve në rajonin I në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Lezhë dhe njësitë arsimore vendore: Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë, Shkodër, Tropojë, Vau i Dejës, do të angazhohen:

A. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Harton modulën/et e trajnimit për komponentët I, II, VII të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025.
- b) Vë në dispozicion të IAL-ve modulet e hartuara.
- c) Realizon workshop-in me pedagogët (trajnerët) e institucionit të arsimit të lartë për përmbajtjen e moduleve të trajnimeve.

- d) Njofton DPAP-në, DRAP-in dhe ZVAP-të për zbatimin e programit dhe për zhvillimin e trajnimeve nga IAL.
- e) Mbledh kalendarët e trajnimit të hartuara nga IAL për DRAP-in përkatës.
- f) Monitoron realizimin e trajnimeve të zhvilluara nga IAL për të siguruar efektivitetin e tyre.
- g) Mbledh të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga IAL për realizimin e trajnimeve.
- h) Siguron burime financiare të nevojshme për zhvillimin e trajnimeve.

B. Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Njeh Programin Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025, miratuar nga MAS me shkresën me nr.1215/1, datë 19.02.2024.
- b) Zbaton procedurat aktuale të procesit të zhvillimit profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar.
- c) Përcakton një koordinator, në nivel IAL-je, për koordinimin e organizimit të trajnimeve.
- d) Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) si dhe me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Lezhë për databazën e mësuesve që do të trajnohen dhe për ndarjen e tyre në grupe trajnimi.
- e) Harton kalendarin e trajnimeve për vitin 2024, në bashkëpunim me DRAP-in Lezhë.
- f) Dorëzon brenda afatit të përcaktuar kalendarin e trajnimeve.
- g) Cakton grupin e trajnerëve pedagogë, sipas kriterëve të përcaktuara, që do të angazhohen në realizimin e trajnimeve të mësuesve.
- h) Komunikon me DPAP-në dhe DRAP-in përkatës për njoftimin e mësuesve dhe për zhvillimin e ditëve të trajnimit sipas kalendarit të hartuar.
- i) Krijon kushte për të përgatitur materialet e trajnimit për secilin pjesëmarrës.
- j) Siguron mjediset e trajnimit, në rastin kur trajnimet zhvillohen në qendër Shkodër, me projektor, laptop, kompjuterë për pjesëmarrësit në trajnim, smartboard (nëse është e mundur).
- k) Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), si dhe me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë për sigurimin e mjediseve të trajnimit në qendra jashtë Shkodrës, me projektor, laptop, kompjuterë për pjesëmarrësit në trajnim, smartboard (nëse është e mundur).
- l) Përgatit certifikatat me kredite për mësuesit e trajnuar sipas databazave të pjesëmarrësve.
- m) Publikon në rrjete sociale veprimtaritë trajnuese.

C. Koordinator i IAL-së, me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Koordinon punën me DRAP-in Lezhë për realizimin e trajnimeve, sipas fushave/profileve përkatëse, duke vënë në dijeni ASCAP-in dhe DPAP-në.
- b) Harton kalendarin e trajnimeve në bashkëpunim me DRAP-in Lezhë, *në të cilin përcaktohen mjedisi i trajnimit, datat, orari, grupi, trajneri.*
- c) Dorëzon kalendarin pranë ASCAP-it dhe DPAP-së.
- d) Komunikon me DRAP-in përkatës për njoftimin e mësuesve dhe për zhvillimin e ditëve të trajnimit sipas kalendarit të hartuar.
- e) Dorëzon në DRAP, DPAP dhe ASCAP databazën në excel të pjesëmarrësve në trajnim.
- f) Kujdeset që trajnerët të përgatisin dhe të zhvillojnë paketën e trajnimit: modulën e trajnimit në bashkëpunim me ASCAP-in, agjendën e trajnimit, fletët e punës, prezantimin në PPT, etj.
- g) Harton raportin përmbledhës për të gjitha trajnimet dhe përgatit të gjithë dosjen e dokumenteve të firmosura nga titullarët e IAL-së dhe e dorëzon në ASCAP.

D. Trajneri i IAL-së për zhvillimin e trajnimeve, me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Zbaton kalendarin e trajnimeve të përgatitur nga koordinatori i IAL-së dhe DRAP Lezhë.
- b) Zhvillon modulet e trajnimit në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ASCAP në përmbajtjen e modulit.
- c) Përgatit agjendën e trajnimit, prezantimin në PPT të modulit, fletët e punës, listë- prezencat e pjesëmarrësve në trajnim.
- d) Realizon seancat trajnuese në mënyrë cilësore dhe efektive.
- e) Përdor platformat online për mbështetjen e trajnimit dhe të procesit të mësimdhënie- nxënies.
- f) Mbështet dhe angazhon pjesëmarrësit gjatë trajnimit.
- g) Kryen testin në përfundim të modulit dhe vlerëson mësuesit pjesëmarrës në përfundim të tij.
- h) Hedh në Excel listën emërore të mësuesve që janë trajnuar.
- i) Përgatit raportin përmbledhës për trajnimet e realizuara nga ai, duke përfshirë problemet e identifikuara dhe sugjerimet për përmirësim, si më poshtë:
 - ☒ Informacion i përgjithshëm mbi procesin e trajnimit.
 - ☒ Ecuria e seancave të trajnimit.
 - ☒ Listë-prezencat, fotot dhe vlerësimet e pjesëmarrësve në trajnim.
 - ☒ Rekomandimet dhe sugjerimet për përmirësim.

E. Drejtoria e Përgjithshme së Arsimit Parauniversitar (DPAP), me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Bashkëpunon me ASCAP-in dhe me IAL-në për të realizuar trajnimin e mësuesve.
- b) Ngarkon DRAP-in për hartimin e kalendarit të trajnimeve, përcaktimin e mjediseve të trajnimit dhe njoftimin e mësuesve.
- c) Ndjek dhe monitoron zhvillimin e trajnimeve nga IAL.
- d) I përgjigjet IAL-së për të dhëna apo për mbështetje logjistike.
- e) Publikon në rrjete sociale veprimtaritë trajnuese të mësuesve.

F. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) Lezhë, me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Bashkëpunon me ZVAP-të përkatëse për të identifikuar mësuesit që do të përfshihen në trajnime.
- b) Harton në mënyrë të detajuar databazën e mësuesve sipas profileve dhe ZVAP-eve dhe ia vë në dispozicion IAL-së.
- c) Bashkëpunon me IAL-në përkatëse dhe koordinatorët e tyre për hartimin e kalendarit, ndarjen e grupeve, përcaktimin e mjediseve dhe njoftimin e mësuesve.
- d) Dorëzon në ASCAP dhe në DPAP kalendarin e trajnimeve të dakordësuar me IAL-në.
- e) Njofton mësuesit për pjesëmarrje në trajnime sipas kalendarit të hartuar në bashkëpunim me IAL-në përkatëse.
- f) Ndjek dhe monitoron sesionet trajnuese të zhvilluara nga IAL përkatëse.
- g) Dërgon në ASCAP listën emërore të mësuesve të trajnuar nga IAL përkatëse.
- h) Komunikon me ZVAP-et për hedhjen e krediteve të mësuesve në portofolin digjital.
- i) Publikon në rrjete sociale veprimtaritë trajnuese.


6. RAPORTIMI

Raportimi për kryerjen e detyrës do të realizohet në dy faza:

Faza e parë - 10 korrik 2024. Në përfundim të kësaj faze, IAL do të dorëzojë:

- Paketën e të gjitha dokumenteve për trajnerët që kanë kryer trajnimet sipas kalendarit të fazës së parë.
- Raportin përmbledhës për të gjitha trajnimet e kryera nga IAL gjatë fazës së parë.
- Databazën përmbledhëse në Excel të emrave të pjesëmarrësve të trajnuar nga IAL gjatë fazës së parë.

Faza e dytë - 20 nëntor 2024. Në përfundim të kësaj faze, IAL do të dorëzojë:

- 
- Paketën e të gjitha dokumenteve për trajnerët që kanë kryer trajnimet sipas kalendarit të fazës së dytë.
 - Raportin përmbledhës për të gjitha trajnimet e kryera nga IAL gjatë fazës së dytë.
 - Databazën përmbledhëse në Excel të emrave të pjesëmarrësve të trajnuar nga IAL gjatë fazës së dytë.

Aneksi 1. Tabela përmbledhëse

Nr	DRAP	Rajoni	ZVAP	Qendra e trajnimit	Totali Dite OS SHPS	Arsim. filitor	Gjuhë shqipe - letërsi	Bio-Kimi	Mat. Fizikë	TIK	TOTAL
1	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	HAS	Kukës	21	72	33	34	24	0	184
2	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	KUKËS	Kukës	61	228	85	77	103	0	554
		Rajoni 1	Totali mësues		82	300	118	111	127	0	738
		Rajoni 1	Totali grupe trajnimi		4	12	5	6	6	0	33
		Rajoni 1	Ditë trajnimi për një grup trajnimi		2	2	4	4	4	4	20
		Rajoni 1	Totali ditë trajnimi gjithsej		8	24	20	24	24	0	100
3	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	KURBIN	Lezhë	47	92	66	41	34	0	280
6	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	MIRDITË	Lezhë	18	52	28	21	28	0	147
4	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	LEZHË	Lezhë	54	186	86	54	88	0	468
		Rajoni 1	Totali mësues		119	330	180	116	150	0	895
		Rajoni 1	Totali grupe trajnimi		6	13	7	6	8	0	40
		Rajoni 1	Ditë trajnimi për një grup trajnimi		2	2	4	4	4	4	20
		Rajoni 1	Totali ditë trajnimi gjithsej		12	26	28	24	32	0	122
5	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	MALËSI E MADHE	IAL Shkodër	27	66	43	30	33	0	199
7	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	PUKË	IAL Shkodër	18	74	73	25	35	0	225
10	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	VAU I DEJËS	IAL Shkodër	24	116	58	31	37	0	266
8	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	SHKODËR	IAL Shkodër	131	406	185	149	133	29	1033
		Rajoni 1	Totali mësues		200	662	359	235	238	29	1723
		Rajoni 1	Totali grupe trajnimi		10	26	14	12	12	1	75
		Rajoni 1	Ditë trajnimi për një grup trajnimi		2	2	4	4	4	4	20
		Rajoni 1	Totali ditë trajnimi gjithsej		20	52	56	48	48	4	228
9	Rajoni 1 = DRAP Lezhë	Rajoni 1	TROPOJË	Tropojë	24	90	34	44	42	10	244
		Rajoni 1	Totali mësues		24	90	34	44	42	10	244
		Rajoni 1	Totali grupe trajnimi		1	4	1	2	2	1	11
		Rajoni 1	Ditë trajnimi për një grup trajnimi		2	2	4	4	4	4	20
		Rajoni 1	Totali ditë trajnimi gjithsej		2	8	4	8	8	4	34
		Rajoni 1	Totali mësues Rajoni 1		425	1382	691	506	557	39	3600

Rajoni 1	Totali grupe trajnimi	21	55	27	26	18	2	159
Rajoni 1	Ditë trajnimi për një grup trajnimi	2	2	4	4	4	4	20
Rajoni 1	Totali ditë trajnimi gjithsej	42	110	108	104	112	8	284

SHKODER



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
REKTORI

Nr. 136/ prot.
3

Shkodër, më 13.03.2024

Lënda: Parashikimi i kostos për trajnimin e mësuesve

Drejtuar: Z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit

I Nderuar Z. Tola

Në përgjigje të shkresës suaj nr 190 Prot, dt 06.04.2024, "Kërkesë për shërbime me fonde buxhetore për trajnimin e mësuesve në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve", lutem gjeni më poshtë parashikimin e kostos për rajonin 1

SUBJEKTET E TRAJNIMIT

- Trajnimi i mësuesve të lëndëve: Trajnimin e mësuesve të lëndëve: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Shkenca (Fizikë, Biologji, Kimi) për aftësitë që zhvillohen në vlerësimin ndërkombëtar PISA dhe sipas qasjes STEM;
- Trajnimin e mësuesve të arsimit fillor në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre për aftësitë që zhvillohen në vlerësimet ndërkombëtare PIRLS, TIMSS sipas qasjes STEM;
- Trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar për aftësitë efektive të mësuesit si: zgjidhja e konflikteve, aftësitë e komunikimit dhe të etikës.

RAJONET

-Rajoni 1: Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë, Shkodër, Tropojë, Vau Dejës

Rubrika trajnime

1. Kohëzgjatja e trajnimit të drejtpërdrejtë për 1 grup trajnimi:

- o Arsimi fillor 1 modul - 2 ditë x 4.5 orë në ditë = 9 orë
- o Menaxhimi i konflikteve 1 modul - 2 ditë x 4.5 orë në ditë = 9 orë
- o Aftësi Komunikimi dhe Etike 1 modul - 2 ditë x 4.5 orë në ditë = 9 orë
- o Gjuhë shqipe 2 module - 4 ditë x 4.5 orë në ditë = 18 orë
- o Matematikë 2 module - 4 ditë x 4.5 orë në ditë = 18 orë
- o Fizikë 2 module - 4 ditë x 4.5 orë në ditë = 18 orë
- o Biologji 2 module - 4 ditë x 4.5 orë në ditë = 18 orë
- o Kimi 2 module - 4 ditë x 4.5 orë në ditë = 18 orë

Parashikohen 484 ditë trajnimi nga 4.5 orë në total 2,178 orë me nga 1.300 lekë. kosto totale del 2,831,400 lekë

Rubrika Dieta, Transport

Parashikohet përfshirja e 37 trajnuesve ku bazuar në distancat, oraret e trajnimit, linjat e disponueshme ndërqytetase parashikohet kosto transporti, dieta dhe fjetje në vlerën 30,000 lekë për person në total 1,110,000 lekë.

Rubrika Fotokopje, Certifikata

2. Numri i pjesëmarrësve gjithsej në trajnim 3600 x 50 lekë për pjesëmarrës del 180.000 lekë.

Kosto totale:

Trajnime 2,831,400 lekë

Dieta, fjetje dhe transport 1,110,000 lekë

Fotokopje Certifikata 180,000 lekë

TOTAL: 4,121,400 lekë

REKTORI

Prof. Dr Rajmonda Këçira

